



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 153 Datë 12.11.2012

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS ME MR. 13, SERIA PV03K, TË
SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “BARMASH”, TE MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR. 20, DATË 19.12.2003, MODIFIKUAR
ME VENDIMIN NR. 79 DATE 23.10.2009**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9; 13 pika 1, gërma “a” dhe 19 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13; 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 gërma “b”, pika 3 dhe pika 4 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, pikave 2.3 dhe 2.4 të Liçensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për modifikimin e liçensës së prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Është dhënë informacioni me shkrim ku shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15 pika 4, gërma “a”);
- Është paraqitur vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës (neni 15 pika 4, gërma “b”).

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë modifikimin e liçensës me nr. 13, Seria PV03K, të shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Barmash”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 20, datë 19.12.2003, modifikuar me vendimin nr. 79 datë 23.10.2009.
2. Fuqia e Instaluar e Hec “Barmash”, nga 630 KW të bëhet 830 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI